

PROCESVERBAL

**nga seanca e 4-ët e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 05.02.2025**

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm edhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: Dimitar Tanurov, mr.Ivona Mufisheva, Magdalena D.Dovleva, Maja Damevska, mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski e hapi seancën e 4-ët të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në orën 15:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë me 5 vota "pro" (z. Jançeski në momentin e votimit nuk ishte i pranishëm në seancë) miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 3-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 29.01.2025.
2. Shqyrtimi i raporteve tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për periudhën nga 1 tetor deri më 31 dhjetor 2024.
3. Propozim – vendim për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor, në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës.
4. Propozim – vendim për pagesë të dëmshpërblimit për humbjen e anëtarit të familjes së ngushtë të punësuarit në Shërbimin Profesional të Agjencisë.
5. Të ndryshme.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi procesverbalin e propozuar të seancës së 3-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 29.01.2025, gjatë së cilës u propozuan disa korrigjime për të përmirësuar saktësinë dhe qartësinë e tij.

Z. Fidanoski vuri në dukje vërejtje teknike në diskutimin e tij në faqet 4 dhe 5, duke theksuar se në procesverbal është shënuar mbiemri i gabuar i bashkëbiseduesit. Ai propozoi korrigjim - në vend të "z. Trajçevski" të shkruhet "z. Trajçev".

Përveç kësaj, z.Trajçev bëri një vërejtje pikësimi në faqen 2, në paragrafin e fundit, ku propozoi që pika të zëvendësohet me pikëpyetje. Në faqen 3, ai vuri në dukje nevojën e korrigjimit të fjalës "propozoi", e cila duhet të zëvendësohet me "pranohet propozimi për të kërkuar interpretim autentik".

Në seancë iu bashkua edhe z. Jançeski, i cili për arsye teknike njoftoi se pjesëmarrja dhe votimi i tij do të realizohet ekskluzivisht përmes audio lidhje.

Këshilli i Agjencisë, me korrigjimet e inkorporuara nga z. Fidanoski dhe z. Trajçev, me gjashtë vota "pro" miratoi procesverbalin e seancës së 3-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportet tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për periudhën nga 1 tetori deri më 31 dhjetor 2024.

Pika 3

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, mr. Ivona Mufisheva, shpjegoi Propozim-vendimin për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor, në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës. Ajo ka shpjeguar se Këshilli ka miratuar Vendim në tetor të vitit 2024, me afat përfundimtar për dorëzimin e aplikacioneve deri më 30 dhjetor 2024. Hapja publike e aplikacioneve të pranuar u bë më 10 janar 2025, nga ku është konstatuar se është dorëzuar vetëm një aplikim. Në periudhën nga data 10 deri më 28 janar 2025, sektorët kompetente kanë vlerësuar aplikimin sipas kriterëve të përcaktuara në konkurs. Vlerësimi rezultoi me ndarjen e 95 pikëve, që tregon se aplikimi i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara. Në bazë të kësaj, propozohet të merret Vendim për dhënien e ejes për kandidatin – person fizik, i cili pas kontrollit në Regjistrin Qendror është konstatuar se nuk ka shkelje të dispozitave të Kreut 4 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

Z. Petrushevski theksoi se si gjithmonë e mirëpret dhënien e lejeve të reja dhe shprehu mbështetje për propozimin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor radio-folëse muzikore me format të përgjithshëm në të cilën llojet e programeve të përfaqësuara përbushin së paku dy nga tri funksionet mediatike, në gjuhën maqedonase, në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, në pronësi të personit fizik.

Shërbimi programor i radios do të transmetohet përmes radiofrekuence të përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike të Republikës së Maqedonisë së Veriut (AKE), përkatësisht: 92,6 MHz.

Leja për transmetim në radio në nivel lokal, jepet për një periudhë 9 (nëntë) vjeçare dhe nuk mund t'i transferohet personi tjetër.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikon në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin për pagesën e ndihmës financiare – dëmshpërblim për humbjen e anëtarit të familjes së ngushtë – bashkëshortit, të punësuarit në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në vlerë prej dy pagash mesatare mujore neto në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht 83,814,00 (tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e katërbëdhjetë) mijë denarë.

Mjetet e mësipërme sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2025.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**